



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2019

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 440 DATË 07.07.2011 "PËR  
VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10 440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis ", të ndryshuar bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 4 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Paragrafi "a" ndryshon me përmbajtje si vijon:

"a) "Projektet ose pjesë të projekteve të përcaktuara në Shtojcën I dhe II të këtij ligji, të hartuar për qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe/ ose për përballimin e emergjencave civile, për të cilat argumentohet se vlerësimi i ndikimit të tyre në mjedis bie ndesh me qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe /ose përballimin e emergjencave civile";

b) Në paragrafin "b" pas togfjalëshit "Ministria e Mbrojtjes..." shtohet togfjalëshi "dhe/apo autoriteti përgjegjës për emergjencat civile" si dhe pas togfjalëshit "...e ndikimeve të rëndësishme negative" shtohet togfjalëshi " , të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis".

### Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto shtesa dhe ndryshime :

1. Pika 3 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“3. “Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

- i. Përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi,
- ii. Kryerjes së konsultimeve, sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;
- iii. Shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, dhe çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi kur është i nevojshëm, si dhe çdo informacion tjetër i rëndësishëm marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;
- iv. Konkluzionit të arsyetuar nga autoriteti kompetent mbi ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent;
- v. Përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit, nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, të konkluzioneve të arsyetuara nga autoriteti kompetent”.

2. Pas pikës 8 shtohet pika 8/1 me përmbajtje si vijon:

“8.1 Autoriteti ose autoritetet kompetente” është autoriteti ose autoritetet e përcaktuara si përgjegjëse për kryerjen e procesit të VNM-së , referuar detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj”.

3. Pika 9 shfuqizohet

4. Pika 10 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“10. “Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit” është institucioni publik që, brenda fushës së përgjegjësisë që mbulon, funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin sektorial përkatës, është përgjegjës për miratimin e zhvillimit për projektet që janë objekt i këtij ligji”.

3. Pika 11 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“11. “Zona të veçanta ruajtjeje” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 81/2017“Për zonat e mbrojtura”.

4. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me përmbajtje si vijon:

“14/1. “Miratim zhvillimi”, është akti i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për projektet që janë subjekt i këtij ligji, që i jep të drejtë zhvilluesit, të vijojë me zbatimin e tij.”

5. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1 me përmbajtje si vijon:

“16/1 “Vlerësimi i Duhur” është procesi që vlerëson rëndësinë e ndikimeve të një projekti të propozuar, në mënyrë individuale apo në kombinim me planet ose projektet e tjera të miratuara ose në zhvillim në Zonat e Veçanta të Ruajtjes, me qëllim informimin në proceset e vendimmarrjes”.

#### Neni 4

Në nenin 7 bëhen shtesat si vijon:

1. Pas pikës I shtohet pika 1/1 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Zhvilluesi, nëse është e nevojshme, kërkon mendim paraprak nga ministria ose AKM-ja, nëse projekti që synon të zhvillojë është objekt i këtij ligji”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me përmbajtje si vijon:

“6. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton me udhëzim shpjegimin e detajuar të projekteve të parashikuara në shtojcat I dhe II të këtij ligji”.

#### Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shkronja “ç” ndryshon me përmbajtje si vijon:

“ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II të këtij ligji, ose që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë, apo nuk lidhen domosdoshmërisht me menaxhimin e një zone të veçantë të ruajtjes, por që ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në këtë zonë, i nënshtrohet edhe Vlerësimit të Duhur, me qëllim sigurimin e autoriteteve kompetente, që ky projekt nuk do të sjellë pasoja në integritetin e zonës”.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me përmbajtje si vijon:

“d) projektet e përcaktuara në shkronjën “ç” më sipër, që i nënshtrohen edhe Vlerësimit të Duhur, identifikohen rast pas rasti nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e zonave të veçanta të ruajtjes, referuar legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura”.

Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe Vlerësimin e Duhur të përcaktuar në pikën 16/1 të nenit 6 të ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, i cili shqyrtohet nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e zonave të veçanta të ruajtjes”.

#### Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i thelluar për projektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, identifikon, përshkruan dhe vlerëson ndikimet e drejtpërdrejta ose jo të projektit minimalisht mbi faktorët e mëposhtëm:

- a. popullsinë dhe shëndetin e njeriut;
- b. biodiversitetin, me vëmendje të veçantë ndaj specieve dhe habitateve të mbrojtura, përcaktuar në aktet nënligjore për miratimin e listave të tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian dhe listës së shpendëve të egër veçanërisht vulnerable
- c. terrenin, tokën, ujin, ajrin dhe klimën;
- ç. pasuritë materiale, trashëgiminë kulturore dhe peizazhin;
- d. ndërveprimin midis faktorëve të përmendura më sipër”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:  
“3. Ndikimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni mbi faktorët e përcaktuar në të, përfshinë edhe efektet e pritshme në rastet e rreziqeve të shkaktuara nga aksidentet madhore industriale dhe/ose fatkeqësive natyrore gjatë zhvillimit të projektit”.

#### Neni 7

Në nenin 11 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1 togfjalëshi “...një projekt i shtojcës II” zëvendësohet me togfjalëshin “...një projekt i përcaktuar në nenin 8, të këtij ligji”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me përmbajtje si vijon:

“4. AKM-ja mund ta zgjasë afatin e marrjes së Vendimit për VNM paraprake, në raste të vecanta që lidhen me natyrën, kompleksitetin, vendndodhjen ose madhësinë e projektit, deri në një muaj nga afati i përcaktuar në zbatim të këtij ligji.. Në këtë rast AKM-ja informon zhvilluesin për arsyet e zgjatjes së afatit, si dhe për datën e marrjes së Vendimit”.

#### Neni 8

Në pikën 1 të nenit 12 togfjalëshi “...autoritetit planifikues” zëvendësohet me togfjalëshin “autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit:”.

#### Neni 9

Në pikën 1 të nenit 15 shkronjat “c”, “ç” dhe “dh” zëvendësohen me shkronjat “c” deri “e”

#### Neni 10

Titulli i Kreut IV ndryshon me përmbajtje si vijon:

“DHËNIA E INFORMACIONIT, RUAJTJA E TË DHËNAVE KONFIDENCIALE DHE KONFLIKTI I INTERESIT”

#### Neni 11

Neni 18 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Neni 18

Dhënia e informacionit

Autoritetet publike, me kërkesë të zhvilluesit apo personit fizik/juridik i pajisur me licencë për hartimin e raportit të VNM-së, vënë në dispozicion të tyre informacionin e disponueshëm për përgatitjen e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare, dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit”.

#### Neni 12

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 19/1

#### Konflikti i interesit

Palët e përfshira në zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë të gjithë aktorët e përshtirë në procesin e konsultimit, garantojnë një vendimarrje të paanshme, transparente nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit ndërmjet interesave publike dhe atyre private, sipas legjisllacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit”.

Neni 13

Titulli i Kreut V ndryshon me përmbajtje si vijon:

“VENDIMI I AUTORITET PËRGJEGJËS PËR MIRATIMIN E ZHVILLIMIT”

Neni 14

Neni 20 ndryshon me përmbajtje si vijon :

“Neni 20

#### Vendimi i autoritetit përgjegjës për miratimin e zhvillimit

1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat të përcaktuar në këtë ligj, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me Deklaratë Mjedisore ose Vendim për VNM paraprake.
2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, kur shqyrton dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit për një projekt, apo vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë Deklaratën Mjedisore ose Vendimin për VNM paraprake për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.
3. Në rast se autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të projektit merr vendim për miratimin e zhvillimit të projektit, në kundërshtim me Vendimin për VNM paraprake apo deklaraten mjedisore, jep argumentet përkatëse për këtë vendim.
4. Akti për miratimin e zhvillimit duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:
  - (a) arsyetimin nga autoriteti kompetent mbi efektet domethënëse të projektit në mjedis, duke marrë parasysh rezultatet e shqyrtimit
  - (b) çdo kusht mjedisor të përcaktuar në Deklaratën Mjedisore apo Vendimin për VNM paraprake, përshkrim të karakteristikave të projektit dhe / ose masat e parashikuara për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar dhe, nëse është e mundur, kompensuar ndikimet e rëndësishme në mjedis, si dhe masat e monitorimit.

Neni 15

Neni 21 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Neni 21  
Miratimi i zhvillimit në Zonat e Veçanta të Ruajtjes

1. Autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit, japin miratimin përkatës vetëm në rast se Vlerësimi i Duhur ka konstatuar se nuk do të ketë efekte të konsiderueshme në integritetin e kësaj zone.
2. Kur projekti duhet të zhvillohet për arsye madhore të interesit publik kombëtar, pavarësisht ndikimeve në zonë të identifikuara në Vlerësimin e Duhur dhe mungesës së zgjedhjeve alternative, autoritetet përgjegjëse miratojnë zhvillimin, vetëm me kushtin që zhvilluesi të marrë të gjitha masat kompensuese me qëllim sigurimin që zona e veçantë e ruajtjes nuk e humb integritetin e saj.

Neni 16

Titulli i Kreut VIII ndryshon me përmbajtje si vijon:

“ANKIMI, MONITORIMI, VLEFSHMËRIA, KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE DHE SANKSIONET”

Neni 17

Nenin 25 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“Neni 25  
Ankimi

1. Çdo palë e interesuar, përfshirë edhe publikun e ndikuar, subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative te ministri ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të ministrisë dhe AKM-së, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Me qëllim rritjen e efektivitetit të dispozitave të këtij neni, ministria dhe AKM-ja publikojnë në faqen zyrtare elektronike informacionin mbi të drejtën e publikut të ndikuar për të drejtën e tyre të ankimit administrativ dhe gjyqësor”.

Neni 18

Në Kreun VIII, pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 25/1

**Monitorimi dhe Vlefshmëria**

1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit dhe ndikimeve të rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në Vendimin për VNM Paraprake apo Deklaratën Mjedisore.
2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit kryen vetmonitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në Vendimin për VNM Paraprake apo Deklaratën Mjedisore.

4. Deklarata Mjedisore apo Vendimi për VNM paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm dhe dokumenti i miratimit të zhvillimit përkatës për projektin.

5. Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të Deklaratës Mjedisore apo Vendimi për VNM paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para”.

#### Neni 19

Neni 26 ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

#### “Neni 26

#### Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) Zhvilluesi që zhvillon një projekt, i cili listohet në shtojcën I dhe II të këtij ligji, pa ju nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe pa u pajisur me Vendim për VNM paraprake, ose Deklaratë Mjedisore, dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë dhe me pezullimin e punimeve.

b) Mospërbushja dhe mosrespektimi i kushteve të Vendimit për VNM paraprake ose Deklaratës Mjedisore nga zhvilluesi i projektit:

i. për Vendimin për VNM paraprake dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

ii. për Deklaratë Mjedisore dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 500 000 lekë

c) Paraqitja e fakteve, të dhënave dhe dokumente të rreme, nga zhvilluesi apo personi fizik/juridik, i pajisur me licencë për hartimin e raportit të VNM-së, të cilat kanë ndikuar në vendimmarrjen e autoritetit kompetent perben veper penale dhe organi administrativ shfuqizon aktin dhe ben kallzim penal.

2. Krahës dënimit me gjobë i parashikuar pikën 1/b të këtij neni, në rast të mospërbushjes dhe mosrespektimit nga ana e zhvilluesit, të kushteve të përcaktuara në Vendimin për VNM-në paraprake ose Deklaratën Mjedisore:

a) AKM-ja për Vendimin e VNM-së paraprake pezullon aktivitetin për zbatimin e projektit nga 1 deri 12 muaj deri në zbatimin e kushteve;

b) Ministri, për Deklaratën Mjedisore, me propozim të AKM-së pezullon aktivitetin për zbatimin e projektit nga 3 deri 12 muaj deri në zbatimin e kushteve;

3. Në rast të pezullimit të Vendimit për VNM-në paraprake ose Deklaratës Mjedisore të përcaktuara në pikën, 2 të këtij neni, zhvilluesi, dorëzon në AKM për shqyrtim dhe miratim, jo më vonë se 30 ditë nga marrja dijani të aktit të pezullimit, dokumentet e mëposhtëm:

a) raportin e detajuar mbi dëmin e shkaktuar, ku të përfshihen masat e marra për parandalimin e dëmeve të mëtejshme;

b) planin i rehabilitimit me qëllim kompesimin e dëmit të shkaktuar, në terma konkret ku përcaktohen masat dhe kohëzgjatja e realizimit të këtij plani.

4. Pas rehabilitimit të zonës, referuar dokumentave të përcaktuara në pikës 3 më sipër, zhvilluesi dorëzon raportin për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe i kërkon autoritetit kompetent shfuqizimin e aktit të pezullimit.
5. Në rast të konstatimit se zona nuk është rehabilituar, AKM-ja shfuqizon Vendimin e VNM-së paraprake dhe në rastin e Deklaratës Mjedisore shfuqizimi bëhet nga Ministri, me propozim të AKM-së.
6. Në rast të konstatimit nga AKM-ja, se akti i miratimit të zhvillimit, është bazuar në një projekt, karakteristikat kryesore të tij janë ndryshuar në mënyrë të ndjeshme nga ato mbi të cilat është bazuar vendimmarrja për Vendimin për VNM paraprake ose Deklaratës Mjedisore, Ministri propozon pranë autoriteteve përgjegjëse shfuqizimin e aktit të miratimit të zhvillimit.
7. Në rast të paraqitjes, nga personi fizik/juridik i pajisur me licencë për hartimin e raportit të VNM-së mbi 3 herë të raporteve të VNM-së me mangësi, bazuar në metodologjinë kombëtare për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri vendos pezullimin apo heqjen e certifikatës dhe njofton autoritetin që ka lëshuar licencën.
8. Në rastet kur shkeljet përbëjnë vepër penale, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit bën kallëzim penal pranë organeve përkatëse.
9. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative si dhe ekzekutimi i masave administrative bëhet në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.

#### Neni 20

Kudo në përmbajtje të ligjit fjala “negative” hiqet.

#### Neni 21

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUCI**



## RELACION

### PER PROJEKTLIGJIN

“PER DISA NDRYSHIME NE LIGJIN NR. 10 440, DATE 07.07.2011  
”PER VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”, I NDRYSHUAR”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QE SYNOHEN TE ARRIHEN

Qëllimi i ligjit është që të përafrojë plotësisht Direktivën 2011/92/EU të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 13 Dhjetor 2011 për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike e private mbi mjedisin (të kodifikuar) (OJ L 26, 28.1.2012, p. 1) të amenduar nga: Direktiva 2014/52/EU e Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 16 Prill 2014 (OJ L 124, 25.4.2014, p. 1), e cila është version më aktual, më i plotë dhe më i pasuruar me detaje i Direktivës bazë të VNM, që ka reflektuar eksperiencën e derisotme të shteteve antare të BE-së me zbatimin e procesit të VNM.

Qëllimi i këtij projektligji është të mbrojë mjedisin në një nivel të lartë përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të ndikimeve në mjedis të disa projekteve të propozuara përpara se të vendoset për miratimin e zhvillimit/zbatimit të tyre. Gjithashtu, projektligji synon të garantojë një proces të hapur, transparent dhe brenda afateve të përcaktuara, me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.

Me ligjin aktual situata është parë që nuk do të sillte përmirësime sa i takon pjesës së koordinimit ndërinstytucional dhe ndarjes së drejtë të përgjegjësiave mes aktorëve të përfshirë në procesin e VNM-së, përfshirë autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit të një projekti publik apo privat, gjë që do të çonte në përkeqësimin e cilësisë së mjedist në Shqipëri, në mungesën e një sistemi të mirëfilltë monitorimi për projektet publike apo private gjatë fazës së zbatimit të tyre në terren, si pasojë do të kemi paaftësi në marrjen e masave të duhura për shmangien apo minimizimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis, që në fazën e projektimit, ndaj shihet me tëpër përparësi miratimi i këtij projektligji.

#### II. VLERESIMI I PROJEKTAKTIT NE RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TE KESHILLIT TE MINISTRAVE,

## ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TE TJERA POLITIKE

Ky projektligj është planifikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave (miratuar me VKM nr.764, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019”). Projektligji është parashikuar për katërmujorin III të vitit 2019, si pjesë e listës me 31 projektakte të planifikuara dhe propozuara nga Ministra e Turizmit dhe Mjedisit.

Gjithashtu, sipas PKIE 2019-2021 (miratuar me VKM nr.201, datë 10.04.2019 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021”), ndër prioritetet për Kapitullin 27-Mjedisit, përfshihet edhe miratimi i projektligjit për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2019 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”.

### III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PERPARESITE, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Problematikat që haset procesi i VNM-së janë se procesi i VNM-së ende nuk kryhet sistematikisht para miratimit dhe fillimit të projekteve nga autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit (lejet zhvillimore, lejet e ndërtimit, lejet minerare, etj.). Konsultimet publike, aksesit në informacion dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile janë përmirësuar ndjeshëm, por duhet të parashikohen në legjislacionin specifik të drejtat e publikut për informacion dhe pë të t’ju drejtuar gjykatës për çështjet mjedisore. Procesi i VNM-së është përmirësuar, por duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme, veçanërisht në sektorët e hidrocentraleve dhe minierave, si dhe projekteve që janë subjekt koncensionit.

Shqipëria ka bërë përparim drejt përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, por gjithsesi një nga rekomandimet e BE-së për nisjen e këtij procesi është nevoja për të siguruar pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së për VNM-në, si rrjedhojë arsyeja e ndërhyrjes së qeverisë nëpërmjet politikës që propozohet konsiston pikërisht në përafrimin e plotë me dispozitat e Direktivës së BE-së për Për vlerësimin e efekteve në mjedis të disa projekteve publike dhe private 2011/92/EU amenduar me Direktivën 2014/52/EU.

Miratimi i këtij projektligji do të mundësojë:

- Përmirësimin dhe forcimin e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri nga zhvillimi i projekteve publike dhe private, nëpërmjet detyrimit që Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar procesit të VNM-së dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me Deklaratë Mjedisore ose Vendim për VNM paraprake;
- Sigurimin i pjesëmarrjes dhe informimit të hershëm të publikut në procedurat e vendimmarrjes mjedisore;
- Ngritjen e sistemit të vetmonitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë ngërtimit dhe zbatimit të projekteve publike dhe private;
- Përcaktimin e kundërvajtjeve administrative dhe sanksioneve në rast të mos zhvillimit të procedurës së VNM-së apo shkeljes së kushteve të përcaktuara në Deklaratën Mjedisore ose Vendimin për VNM paraprake në varësi të projektit.

#### IV. VLERESIMI I LIGJSHMERISE, KUSHTETUTSHMERISE DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NE FUQI VENDAS E NDERKOMBETAR

Projektligji është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe në harmonizim me ligjin nr. 10431, date 09.6.2011, “Per mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar.

Projektligji synon të bëjë përafrimin e plotë (të atyre neneve që nuk janë traspozuar nëpërmjet legjislacionit në fuqi për VNM-së) të Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private”, të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Prill 2014. Projektligji adreson dhe kërkesat e Konventës ESPOO (Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkuftar), Konventës së Aarhusit, ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikim e Konventës së Aarhusit “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”.

#### V. VLERESIMI I SHKALLES SE PERAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PER PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ndryshimet e propozuara në projektligj transpozojnë plotësisht pjesën e pa traspozuar deri më tani të Direktivës 2011/92/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 dhjetor 2011 "Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private", të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 Prill 2014. Ky ligj përaftron edhe një pjesë të Direktivës së Këshillit 92/43 / KEE të datës 21 maj 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër, që lidhet me Vlerësimin e Duhur (Appropriate Assessment), përkatësisht nenin 6 të kësaj direktive.

## VI. PERMBLEDHJE SHPJEGUESE E PERMBAJTJES SE PROJEKTAKTIT.

Për të lehtësuar kuptimin e këtij projektligji sqarojmë se parimet e procedurës dhe institucionet përgjegjëse, si dhe projektet bazë që duhet t'i nënshtrohen procesit të VNM-së (paraprak apo të thelluar) janë përcaktuar e miratuar në ligjin 10440, date 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" i ndryshuar; VKM nr. 686, datë 29 korrik 2015 "Mbi miratimin e rregullave, përgjegjësi dhe afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis"; VKM nr. 247 date 30.04.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore"; VKM nr. 598, datë 01.07.2015 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin e ndikimit në mjedisin ndërkuftar"; VKM nr. 912, datë 11.11.2015 "Për miratimin e Metodologjisë Kombëtare për hartimin e raporteve të Vlerësimit të ndikimit në mjedis"

Ky projektligj synon të përcaktojë:

- Autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohen që projekti t'i jetë nënshtruar procesit të VNM-së dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me Deklaratë Mjedisore ose Vendim për VNM paraprake;
- Detyrimin e përfshirjes dhe informimin e publikut në procedurat e vendimmarrjes mjedisore;
- Sistemin e vetmonitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë ndërtimit dhe zbatimit të projekteve publike dhe private është funksional;

- Kundërvajtjet administrative dhe sanksioneve në rast të mos zhvillimit të procedurës së VNM-së apo shkeljes së kushteve të përcaktuara në Deklaratën Mjedisore ose Vendimin për VNM paraprake në varësi të projektit janë të mirë përcaktuara;

Me synim përmbushjen e rekomandimeve të BE-së dhe hartimin e politikave me të plota, bazuar në të dhëna konkrete për procesin e VNM-së.

Neni 1 shfuqizon nenin 4 të ligjit ekzistues, pasi ky nen përcakton kërkesat e përgjithshme për raportin e thelluar të VNM-së, të cilat janë detajuar në shtojcën II të VKM nr. 686/2015, e cila ka traspozuar kërkesat e Direktivës 2011/92/EU të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU.

Neni 2 transponon nenin përkatës të direktivës, i cili parashikon se projektet e përcaktuara në ligjin ekzistues të VNM-së, të hartuar për qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe/ ose për përballimin e emergjencave civile, për të cilat argumentohet se vlerësimi i ndikimit të tyre në mjedis bie ndesh me qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe /ose përballimin e emergjencave civile përjashtohen nga detyrimi për t'ju nënshtuar procesit të VNM-së. Këto projekte përcaktohen rast pas rasti.

Në nenin 3 janë parashikuar ndryshimet apo shtesat në termat me qëllim përshatjen e plotë të terminologjisë me atë të Direktivës 2011/92/EU të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU.

Në nenin 4 i është dhënë e drejta zhvilluesit që nëse është e nevojshme, t'i kërkojë mendim paraprak ministrisë ose AKM-së, nëse projekti që synon të zhvillojë është subjekt i këtij ligji. Si dhe është përcaktuar që ministri miraton me udhëzim shpjegimin e detajuar të përkufizimit të projekteve të listuara në shtojcat I dhe II të këtij ligji, me qëllim lehtësimin e kuptimit të këtyre projekteve që është e nevojshme t'i nënshtrohen procesit të VNM-së.

Neni 5 bën disa shtesa dhe ndryshime të nenit 8 të ligjit ekzistues me qëllim përcaktimin më të detajuar të projekteve që duhet t'i nënshtrohen procedurës paraprake të VNM-së, duke përfshirë edhe projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II të këtij ligji, ose që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë, apo nuk lidhen domosdoshmërisht me menaxhimin e një zone të veçantë të ruajtjes, por që ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në këtë zonë, i nënshtrohet edhe Vlerësimit

të Duhur, me qëllim sigurimin e autoriteteve kompetente, që ky projekt nuk do të sjellë pasoja negative në integritetin e zonës, referuar edhe kërkesave të nenit 6 të Direktivës së Këshillit 92/43 / KEE të datës 21 maj 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër.

Neni 6 bën disa shtesa dhe ndryshime të nenit 9 të ligjit ekzistues me qëllim përcaktimin më të detajuar të projekteve që duhet t'i nënshtrohen procedurës të thelluar të VNM-së, duke përfshirë edhe faktorët mbi të cilët duhet të bazohet raporti i thelluar i VNM-së.

Në nenin 7 të projektligjit është parashikuar ndryshimi që lidhet me mundësinë se AKM-ja mund ta zgjasë afatin e marrjes së Vendimit për VNM paraprake, në raste të vecanta që lidhen me natyrën, kompleksitetin, vendndodhjen ose madhësinë e projektit, deri në një muaj.

Neni 8 bën një zëvendësim termash nga “autoritetit planifikues” në “autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit” duke përfshirë të gjithë autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit për një projekt që është objekt i këtij ligji (KKT, K KU, KM, Parlament, ministri të linjës, bashki, etj.), pra nuk ndalet vetëm tek autoritetet përgjegjëse për planifikimin e territorit, kjo gjë është parashikuar edhe në terminologjinë e këtij ligji, neni 3, pika 4.

Në nenin 9 bëhet një përshtatje e parashikimit që ishte në ligjin ekzistues, duke saktësuar referencat e pikës 1 të nenit 14.

Neni 10 ndryshon titullin e Kreut IV të ligjit ekzistues duke shtuar konceptin e konfliktit të interesit, ndërkohë që neni 11 ndryshon përmbajtjen e nenit 18 të ligjit ekzistues duke e përshatur me kërkesat e direktivës.

Në nenin 12 parashikohet shtimi i nenit 19/1 që lidhet me konfliktin e interesit, sipas kërkesave të direktivës dhe neni 13 ndryshon titullin e Kreut V të ligjit ekzistues duke ndryshuar konceptin nga nga “autoritetit planifikues” në “autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit” duke përfshirë të gjithë autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit për një projekt që është objekt i këtij ligji.

Neni 14 ndryshon nenin 20 të ligjit ekzistues që lidhet me detyrimin që i përcaktohet autoriteteve përgjegjëse për miratimin e zhvillimit se procesi i VNM-së duhet të kryhet sistematikisht para miratimit të projekteve nga autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit (lejet zhvillimore, lejet e ndërtimit, lejet minerare, koncensionet etj.), pra në këtë nen përcaktohet se Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohet që projekti t'i jetë nënshtruar procesit të VNM-së dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me Deklaratë Mjedisore ose Vendim për VNM paraprake.

Neni 15 ndryshon nenin 21 të ligjit ekzistues për të traspozuar plotësisht kërkesat e nenit 6 Direktivës së Këshillit 92/43 / KEE të datës 21 maj 1992 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër.

Neni 16 ndryshon titullin e Kreut IV të ligjit ekzistues duke shtuar konceptin e monitorimit dhe kundërvajtjet administrative/sanksionet.

Neni 17, ndryshon nenin 25 të ligjit ekzistues në lidhje më procesin dhe të drejtën e ankimimit duke e sjellë në një frymë me kërkesat e direktivës.

Në nenin 18 parashikohet shtimi i nenit 25/1 që lidhet me procesin monitorimit të ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis gjatë ndërtimit dhe zbatimit të projekteve publike dhe private, si dhe parashikon se nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të Deklaratës Mjedisore apo Vendimi për VNM paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

Neni 19 prashikon kundërvajtjet administrative dhe sanksionet në rast të mos zhvillimit të procedurës së VNM-së apo shkeljes së kushteve të përcaktuara në Deklaratën Mjedisore ose Vendimin për VNM paraprake në varësi të projektit.

Në nenin 20 është parashikim për heqjen e fjalës “negative” në përmbajtjen e ligjit bazë dhe neni 21 parashikon hyrjen në fuqi të projektligjit.

## VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QE NGARKOHEN PER ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe autoritet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit për zbatimin e këtij ligji.

#### VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin dhe në Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, si dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

#### IX. RAPORTI I VLËRESIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, pasi të gjitha strukturat për shqyrtimin dhe pranimin e aplikimeve për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë të ngritura.

MINISTRI

Blendi Klosi